

KËRKESË PËR OFERTË (TENDER)

Informacion mbi dorëzimin e ofertave (Tender)

- 1. Kodi i referencës së prokurimit:** Nr. i Proc. <Prot/ 65/25 Data 18.09.2025>
- 2. Projekti:** <"Fuqizimi i kapaciteteve të Qendrës Sociale Komunitare Zinxhira për të ofruar shërbime të specializuara dhe gjithpërfshirëse për komunitetet në nevojë".>
- 3. Lënda e kontratës:** Për Blerjen e një Automjeti për të ofruar Shërbime Lëvizëse.>
- 4. Autoriteti Kontraktor:**<Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri >
- 5. Buxheti maksimal:**< 2,359,751.58 LEKË> (pa TVSH)
- 6. Afati i fundit për aplikim:**<02.10.2025>, ora <23:50>
- 7. Përshkrimi i kontratës**

Qëllimi i kësaj kontrate është blerja e një automjeti të përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve lëvizëse kontakti per Qendrën Sociale Komunitare Zinxhira në territorin e Bashkisë Gjirokastrë. Ky automjet do të shërbejë për transportin e stafit dhe për materialet e nevojshme për shërbimet sociale të ofruara nga kjo qendër për komunitetet në nevojë, duke minimizuar barrierat për aksesin e shërbimeve të ofruara në qendër.

8. Kërkesat teknike

Automjeti duhet të përmbushë këto kritere minimale :

Përshkrimi	Ofruar
Automjet	I papërdorur, me kilometrazh 0 (zero)
Viti i prodhimit	2022 e në vazhdim (duke përfshirë vitin 2022)
Tipi	Automjet (Tipi Fuoristradë ka avantazh)
Numri i vendeve	Minimumi 4+1 (katër plus një)
Dyer	Minimumi 5 (pesë)
Lënda e punimit të motorit	Elektrike; ose Hibride; ose Naftë
Shpejtësia maksimale	130–200 km/h
Autonomia e karikimit në rast se elektrike.	Jo më pak se 400 km
Kapaciteti i baterisë	75–90 kWh
Karikim i ngadaltë	6.5–8.5 orë
Karikim i shpejtë	30–50 minuta
Fuqia motorike	95–120 kuaj fuqi
Fuqia maksimale	100–150
Fuqia rrotulluese maksimale	210–310 N.M
Tërheqje fuqia	Minimumi 65–95 kW

A. SISTEME TE SIGURISË DHE NDIHMËS

- Sistem adaptiv i kontrollit të lundrimit Stop & Go
- Ndhma e përparme me sistem frenim i automatik
- Ndhma në mbajtjen e korsisë
- Njohja e shenjave të komunikacionit

B. PAJISJET DHE KOMODITETI

- Sistemi i kontrollit të temperaturës së baterisë me efikasitet të lartë
- Kamera dhe sensorë parkimi
- Pasqyra me palosje dhe ngrohje
- Sedilje elektrike me ngrohje dhe masazh
- Timon shumë funksional
- Panel dixhital i shoferit
- Sistemi i navigimit i prekshëm 12– 12inch
- Disqe alumini 18– 20inch
- Ajër i kondicionuar
- 4 xhama elektrike
- Xhami i pasëm me rezistencë
- Fshirëse xhami për para me interval të ndryshëm
- Fshirëse xhami mbrapa

C. DRITAT DHE BAGAZHI

- Drita/fenere LED me shumë sy, të integruara (dritatë gjata dhe të shkurtra)
- Kapaciteti i bagazhit : 300–700 litra

Aplikantët duhet të ofrojnë shërbime cilësore në bazë të nevojave dhe bazuar në kërkesat minimale teknike siç tregohet më sipër.

9. Procedura e aplikimit/Përmbajtja e ofertave

Ofertat, të gjitha korrespondencat dhe dokumentet që lidhen me ofertën e shkëmbyera nga ofertuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të jenë të shkruara në shqip.

Oferta duhet të përmbajë një ofertë teknike duke përfshirë dokumentet mbështetëse të kërkuara dhe një ofertë financiare:

a) Oferta teknike

Oferta teknike duhet të përfshijë dokumentet mbështetëse të mëposhtme:

1. Aneksi A- Ofertë financiare për blerjen e automjetit (shprehur me vlerë mujore, pa TVSH). (Format i A, bashkëlidhur i firmosur dhe vusolur nga administratori, ose person i autorizuar.)
2. Dokumentacioni ligjor (ekstrakti nga QKB dhe NIPT-i).

3. Leje Qarkullimi Automjeti të vlefshëm.
4. Targë
5. Certifikatë pronësie në emër të ofertuesit
6. Dokumentacioni i sigurimit të automjetit(Siguracion).
7. Aneks B - Fotografi dhe përshkrim teknik i automjetit që ofrohet për shitje.
8. Garanci teknike për një periudhë 3 (tre) vjeçare. (Dokument që e vertëton.)

b) Oferta financiare

Oferta financiare duhet të paraqitet si një shumë në LEKË dhe duhet të dorëzohet duke përdorur modelin e Ofertës Financiare (Shtojca I) siç është dhënë nga Autoriteti Kontraktor.

Aplikantët e ftuar duhet të specifikojnë [tarifën që ofrojnë në LEKË (pa TVSH), për secilin artikull, në përputhje me listën e shërbimeve të kërkuara siç tregohet në pikën 8].

Vlera e ofertës duhet të përfshijë të gjitha kostot dhe detyrimet fiskale të parashikuara nga ligji në fuqi dhe do të mbetet e pandryshuar pavarësisht ndryshimeve që mund të bëhen në legjislacionin përkatës. Nëse ka tarifa bankare, këto tarifa do të ndahen dhe secila palë do të ngarkohet me tarifat e veta bankare.

10. Kriteret e dhënies së kontratës

Të gjitha ofertat do të vlerësohen bazuar në kriterete mëposhtme:

- **OFERTA TEKNIKE–60 PIKË(60%)**
- **Përputhshmëria mes pecifikimet teknike–30 pikë.**
- **Karakteristika shtesë mbi minimumin e kërkuar –10 pikë**

(P.sh. Autostrade, kapacitet më i madh bagazhi,bateri me jetë gjatësi më të lartë,sisteme sigurie shtesë, pajisje komoditeti më të avancuara dhe qe lehtësojnë ofrimin e shërbimeve komunitare etj).

- **Garancia teknike-10pikë**

(Minimumi 3 vite).

- **Konsumi dhe efikasiteti i karikimit– 5 pikë**

(Koha më e shkurtër e karikimit dhe efikasitet energjie më i lartë, ne rastin e makinave eletrike).

- **Përshtatshmëria për terrenet e zonave të largëta–5 pike**

(Vlerësohet fuqia tërheqëse,sistemi i tërheqjes,kapaciteti për rrugë të vështira)

OFERTA FINANCIARE –40 pikë (40%)

- **Çmimi më i ulët merr 40pikë.**

- Ofruesi te tjerë marrin pike sipas formulës:

Totali Pikëve :100

- Oferta teknike: 60%
- Oferta financiare: 40%

Operatori ekonomik me pikët më të larta në total (teknike+financiare) do te shpallet fitues.

11. Dorëzimi i ofertës

Kjo thirrje do te qendroje e hapur pergjate periudhes 18 shtator 2024- 2 tetor 2025. Ofertat duhet të dorëzohen brenda **datës 2 Tetor 2025 ora 23:50** në adresën e e-mailit prokurime.irca@gmail.com .

ose

dorazi të mbyllur me zarf në adresën :

Instituti I Kultures Rome ne Shqiperi : Rr.Kristaq Prifti, ND.9 , H2,D/A Yzberish Tiranë, Kutia PO.Box 154 Tirana, 1052.

Siper zarfit shkruani dhe Aplikim Tender reference no/65-25